

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *“Rrjeti i Brendshëm Ujësjetës, KUZ viti 2024”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** *45210000-2*

#### **PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.* Specifikimet Teknike janë pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike, argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**8.332.516** (tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas manualit teknik per vitin 2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **SPECIFIKIMI**

##### **1. Germim dhe mbushje dheu me krah**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> germim dhe dhe mbulim kanal me krahe duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor.

## **2. Hedhje rafshim dhe mbulim kanali**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> mbulim dhe rafshim kanali panvaresisht nga kategoria e tokes ose menyra e realizimit te tij me krah ose me mjete te mekanizuar Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor.

## **3. F.V Tuba rakorderi ujesjellesi PN16 Ø =110mm Ø =63mm, Ø = 50mm, Ø =40mm, Ø =32mm ,Ø = 25mm**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 ml tubo ujesjellesi PN 16,PN 16 Ø =110mm Ø =mm , Ø = 50mm, Ø = 32mm Ø = 25mm ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike dhe kerkesave te projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin , blerjen e materialeve , transportin dhe vendosjen ne veper sipas profilave gjatesore. Tubot duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise te prodhimit te BE. Pavec cdo kerkese tjeter te gjitha pajisjet e kerkuara sipas kontrates duhen te projektohen dhe prodhohen per tu rezistuar te gjitha provave te presionit sic tregohet ne projekt.Tubat gjete trasportit duhet te shtrihen mbi nje siperfaqe te sheshte duke shmangur cdo demtim te mundshem.

## **4. Ndertim pusete shperndarese 50x50x100cm, 80x80x100 cm C 16/20**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete beton me permasat e caktuara ne preventive per puseta shperndarese C 16/20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit.

## **5. F.V. Saraqineske bronxi Ø 1 1/4” = 32mm**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 cop saraqineske bronxi Ø 1 1/4 = 32mm ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike me PN 10. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin, blerjen e materialeve, transportin dhe vendosjen ne veper sipas kerkesave te Sektorit te Ujesjellsit. Saraqineskat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise te prodhimit te BE.

## **6.F.V. Saraqineske gize me fllanxhe PN 16 bar Ø = 50mm dhe 100 mm**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 cop saraqineske gize me fllanxhe PN 16 bar Ø = 50mm dhe 100 mm ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike me PN 16. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin, blerjen e materialeve, transportin dhe vendosjen ne veper sipas kerkesave te Sektorit te Ujesjellsit. Saraqineskat duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise te prodhimit te BE.

## **7.Hidroizolimi me emulsion bitumi dhe 1 dore karton katrama.**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>2</sup> shtrese hidroizolimi emulsion bitumi + 1 dore karton katramal. Hidroizolimi do te realizohet ne gjithë sipërfaqen e objektit. me nje dore emulsion bitumi plus kartonin katrama. Shtresa do te lyhet me prajmer dhe me pas do te vendoset shtresa e kartonit katrama e cila do te nxehtet me llambe me gaz per te realizuar ngjitjen. Katramaja do te jete importi me t=4.5 mm.

#### **8. Beton C – 16/20**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> beton C – 16 / 20 per ndertim bazamenti, mure betoni dhe soletes per depon, kanalit ,pallakave prej betony sipas projektit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas faktit, ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit.

#### **9. Suvatim cemento i brendshem M50**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>2</sup> suva cemento mur betoni ne lartesi deri ne 4 m me krahe llaç cemento. Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm Ilaci cemento 1:2 me dozim per m<sup>2</sup> : rere e lare m<sup>3</sup> 0,005, cemento 528 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire dhe cdo detyrim tjetër per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

#### **10. F.V. Hekur betoni**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per F.V. ne veper e 1 ton hekuri. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve hekur sipas Ø, tel bari, transportin. Ne cmim futet pergatitja e hekurit sipas projektit dhe lidhja ne veper sipas projektit.

#### **11. Germim dheu seksion i detyruar**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m<sup>3</sup> germim dheu , kanali panvaresisht nga kategoria e tokes ose menyra e realizimit te tij me mjete te mekanizuar dhe shkarkim ne toke Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor. .

#### **12. F.V. Tub korogato HDPE SN8 Ø =200, Ø = 315, Ø = 400**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 ml tubo korogato HDPE SN8 Ø =200, Ø = 315 Ø = 400 ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike dhe kerkesave te projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin , germimin e dheut , ndertimin e shtreses te bute pa gure , transportin dhe vendosjen ne veper sipas profilave gjatesor. Tubot I ka investitori.

#### **13. Ndertim pusete shkarkimi me kapak gize 0.8x0.8x1.5 m C 16/20**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete beton 08x08x1.5 m C 16/20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit

#### **14.Ndertim pusete 50x50x100 cm. C 16/20**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete beton 50x50x100 cm. C 16/20 per lidhjet familjare me rjetin kryesor. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin se blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

*ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.*

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.**

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

*Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2023 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Ose**

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

## **Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vertetim për kryerjen me sukses të kontrates

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

#### **Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

##### **a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:**

1. NP 1 - A ( Punime gërmimi në tokë)
2. NP 3 - A ( Rikonstruksion mirembajtje godinash civile e industriale)
3. NP 7 - A (Ujësjetës,kanalizime,vepra kullimi e ujitje)
4. NS 1 - A ( Punime për prishjen e ndertimeve)

*\*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr pjesë për të realizuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimi i kërkuar për kategori në respektive	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	<i>Punime gjurmimi në tokë</i>		A	
NP 3	Rikonstrukcion mirembajtje godinash civile e industriale		A	
NP 7	<i>Ujësjetës,kanalizime,vepra kullimi e ujitje</i>		A	
NS 1	<i>Punime për prishjen e ndertimeve</i>		A	

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate ne formularin përmbledhës të vetëklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë të perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

- **Inxhinier hidroteknik (1)**

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

**2.3.4** Operatori ekonomik, duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate sipas formularit permbledhes te vetëklarimit** se për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

**- Inxhinier Ndertimi (1)**

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

*Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim **ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike**, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.***

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne Pune”*, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

**Argumentimi:** Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier hidroteknik dhe një inxhinier ndertimi si staf mbështetës.

**2.3.6** Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilesise).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*



*Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë", si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.7** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 7 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Hidraulike** (2)
- **Murator** (3)
- **Hekurpunues** (1)

***"Për punonjësit e mësipërm në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :***

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);  
ose  
Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Manovrator** (1)

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

**Kur mjetet janë ne pronesi**

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

**Kur mjetet janë me qera**

*Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin( i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor ) deri në perfundimin e afateve të kontratës.*

- **Murator**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit vendosje puseta, punime betoni ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 3 murator të cilët do të realizojnë këto punime.*

- **Manovrator**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Germim dheu me eskavator me goma , kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1 manovrator që do të realizojë këto punime.*

- **Hidraulik**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit FV tubo e rakorderi ujesjellesi ,kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 2 hidraulik që do të realizojnë këto punime.*

- **Hekurpunues**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit FV hekur betoni ,kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 hekurpunues që do të realizojnë këto punime.*

**Argumentimi:***Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënimi-argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 13 persona**, Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Kriteret e percaktuara në pikën 2.3.8. Eshtë kërkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 10 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zbërthimi i preventivit të punimeve me manualin e*

*miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 13 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.*

#### ZBERTHIMI I PREVENTIVIT

NR	NR.AN	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	Njesia	Sasia	OP/NJ	OP Gjith
<b>A</b>		<b>UJESJELLES I FSHATI LOZHAN</b>				
<b>I</b>		<b>LINJE E BRENDSHME E UJESJELLESIT</b>				
1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ,kanal me gjerësi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	225	0.067	15.08
2	3.47/a	Hedhje, rafshim ,mbushje dheu me krahe kat e III	m <sup>3</sup>	200	0.44	88.00
3	2.15	Germim dhe mbushje dheu me krahe H=1.5 m	m <sup>3</sup>	700	3.80	2,660.00
4	2.491/h	F.V. tuba e rak.ujesjellesi PE d=110mm,t=6.7mm PN 16	ml	110	0.30	33.00
5	2.491/f	F.V. tuba e rak.ujesjellesi PE d=63mm,t=3.7mm PN 16	ml	475	0.03	14.25
6	2.491/e	F.V. tuba e rak.ujesjellesi PE d=50mm,t=3.7mm PN 16	ml	330	0.03	9.90
7	2.491/d	F.V. tuba e rak.ujesjellesi PE d=40mm,t=3.0 mm PN 16	ml	270	0.30	81.00
8	2.491/c	F.V. tuba e rak.ujesi PE d=20-32mm PN 16	ml	150	0.30	45.00
9	2.491/b	F.V. tuba e rak.ujesjellesi PE d=20-25mm PN 16	ml	1250	0.03	37.50
10	An 4	Pusete shperndarese b/a 80x80 x100 cm	cope	1	7.40	7.40

	An	Puse komandimi 50x50x100 cm	copë	2	4.5	9.00
11	4,123/1	F.V Saraqineska gize me fillanxhe PN -16 bar Ø 50mm	cope	5	2.60	13.00
12	4,123/4	F.V Saraqineska gize me fillanxhe PN -16 bar Ø 100mm	cope	1	2.60	2.60
	2.494/3	F.V Saraqineska bronxi Ø1 1/4"= Ø 32mm (pallati)	cope	2	2.60	5.20
15	2.538	F.V Tub celiku Ø 200mm(kalim ne perua)	kg	200	0.025	5.00
		<b>SHUMA I</b>				0.00
<b>II</b>		<b>RIKOSTRUKSION DEPO FSHATI LOSHAN</b>				0.00
1	2.426/4	Prishje soleta b/a	m3	6	1.75	10.50
2	2.426/1	Prishje mur tulle	m3	5	6.20	31.00
3	2.166	F.V Hekur betoni periodikØ 6-10 mm	ton	0.150	60.00	9.00
4	2.167	F.V Hekur betoni periodikØ>10 mm	ton	0.300	42.00	12.60
5	4.5	Shkalle metalike	kg	85	0.03	2.89
6	2.538	Tuba celiku (lidhja e teprerdhesis)	kg	70	0.02	1.40
7	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	0.5	2.90	1.45
8	2.262/4	Beton per (shtresa poshte) t=10 cm C 16/20	m3	2.5	8.60	21.50
9	2.262/4	Beton per soleta t=15 cm C 16/20	m3	4.5	8.60	38.70
10	2.262/4	Brez b/a C16/20	m3	3	8.60	25.80
11	2.312	Suva mur guri me krah brenda M25	m2	45	1.75	78.75
12	2.264	Shtrese me lluster cemento	m2	20	0.66	13.20
13	2.196/c	Hidroizolim me 2 shtresa astar me baze cemento (nga brenda)	m2	45	0.70	31.50
14	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 katrama(solete)	m2	40	0.70	28.00
15	3.396/2	Mbushje me argjile pas mureve	m3	10	5.00	50.00
16	2.203	F.V. Lamarine xingato	m2	0.8	1.60	1.28
17	2.390/1	F,V Dere metalike	m2	1.5	2.40	3.60
18	2.401	Lyerje me boje vaji sip. Metalike	m2	3	1.47	4.41
19	2.37/1b	Transport materiale me kafshe deri 1.0 km	ton	10	4.00	40.00
20	3.837/a	Rrethim me rjrte teli	m2	30	2.00	60.00
		<b>SHUMA II</b>				0.00
		<b>SHUMA A</b>				0.00
<b>B</b>		<b>NDERTIM K.U.Z NE NJESITE ADMINISTRATIVE</b>				0.00
<b>I</b>		<b>K.U.Z FSHATI VLOCISHT</b>				0.00

1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	1005	0.067	67.34
2	3.158/1a	Trasport dheu me auto.derri 1 km	m <sup>3</sup>	125	1	125.00
3	An	Vendosje tuba te brinjezuara d=200mm (puna)	ml	1100	0.15	165.00
4	An	Vendosja tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=315mm(puna)	ml	280	0.2	56.00
5	An	Vendosje tuba te brinjezuara d=200 mm (lidhje familjare)(puna)	ml	165	0.15	24.75
6	An	Puse kontrolli 0.8x0.8x1.5m kapak gize	copë	33	7.4	244.20
7	An	Puse shkarkimi 50x50x100 cm (Lidhje familjare)	copë	30	4.5	135.00
8	3.47/1a	Hedhje ,rrafshim mbushje dheu me tokmak elektrik	m <sup>3</sup>	770	0.44	338.80
		<b>SHUMA I</b>				0.00
<b>II</b>		<b>K.U.Z FSHATI VELITERNE</b>				0.00
1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	400	0.067	26.80
2	3.158/1a	Trasport dheu me auto.derri 1 km	m <sup>3</sup>	40	1	40.00
3	An	Vendosje tuba te brinjezuara d=200mm (puna)	ml	260	0.15	39.00
4	An	Vendosja tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=315mm(puna)	ml	190	0.2	38.00
5	An	Vendosje tuba te brinjezuara d=200 mm (lidhje familjare)	ml	85	0.15	12.75
6	An	Puse kontrolli 0.8x0.8x1.5m kapak gize	copë	12	7.4	88.80
7	An	Puse shkarkimi 50x50x100 cm (Lidhje familjare)	copë	17	4.5	76.50
8	3.47/1a	Hedhje ,rrafshim mbushje dheu me tokmak elektrik	m <sup>3</sup>	260	0.44	114.40
		<b>SHUMA II</b>				0.00
<b>III</b>		<b>K.U.Z FSHATI KLOCE</b>				0.00
1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	430	0.067	28.81
2	3.158/1a	Trasport dheu me auto.derri 1 km	m <sup>3</sup>	50	1	50.00
3	3.25/b	Germim me krahe seksion i detyruar b<1 h=1.5 ,tok e zak	m <sup>3</sup>	50	3.6	180.00
4	An	Vendosje tuba te brinjezuara d=200mm (puna)	ml	100	0.15	15.00
5	An	Vendosja tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=315mm(puna)	ml	225	0.2	45.00
6	An	Vendosje tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=400mm (puna)	ml	150	0.3	45.00
7	An	F.V. Tuba te brinjezuara d=200 mm (lidhje familjare)(puna)	ml	100	0.15	15.00

8	An	Puse kontrolli 0.8x0.8x1.5m kapak gize	copë	13	7.5	97.50
9	An	Puse shkarkimi 50x50x100 cm (Lidhje familjare)	copë	20	4.5	90.00
10	3.47/1a	Hedhje ,rrafshim mbushje dheu me tokmak elektrik	m3	270	0.44	118.80
		<b>SHUMA III</b>				0.00
<b>IV</b>		<b>K.U.Z FSHATI ZVARISHT</b>				0.00
1	2.25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m3	100	0.07	6.70
3	An	F.V.Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200mm	ml	230	0.15	34.50
4	3.47/1a	Hedhje, rafshim ,mbushje dheu me krahe kat e III	m3	90	0.44	39.60
5	An	Puse kontrolli 0.8x0.8x1.5m kapak gize	copë	4	7.4	29.60
	An	Puse shkarkimi 50x50x100 cm (Lidhje familjare)	copë	11	4.5	49.50
		<b>SHUMA IV</b>				0.00
<b>V</b>		<b>KANAL K.U.B. BETONI VRESHTAS L= 120 ml</b>				0.00
1	2.26/a	Germim dheu me eskavator me goma0.25m3 ne kanale me gjeresi deri 2m toke e zak kategori III me shk ne mjet	m3	36.0	0.07	2.41
2	3.158/1a	Trasport dheu me auto.derri 1 km	m3	36.0	1.00	36.00
3	3.183/a	Shtrese zhavori lumi t=10 cm	m2	207.0	0.13	26.91
4	2.262/4	Struktura monolite betoni C-16/20 (muret dhe shtresa e kanalit)	m3	46.0	8.60	395.60
5	2.166	Hekur betoni I zakonshem Φ6-10 mm(zgare hekuri cdo Ø6/15 cm)	ton	0.8	60.00	48.00
6	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	ml	21.0	5.60	117.60
7	2.262/4	Struktura monolite betoni C-16/20 (pllakat mbi kanal 1.8x0.5x0.1 m)	m3	7.5	8.60	64.50
8	2.166	Hekur betoni I zakonshem Φ6-10 mm(pllakat me zgare hekuri cdo Ø6/15 cm)	ton	0.2	60.00	12.00
		<b>SHUMA</b>				6,631.87

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 6632
- Oret në total i pjetojmë me 8 orë pune ditore 6632 : 8 = 829 kemi 829 punëtorë për një ditë pune
- 829 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 38 punëtorë për një muaj punë.
- Per 3 muaj pune duhen 13 punonjes.

**2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :**

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
2. Kamioncine me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
3. Motobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
4. Kamion vetshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 16 ton deri 18 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
5. fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
6. Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Motosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave ) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

per mjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

1- Eskavator 1 cope

Është kërkuar 1 eskavator bazuar në zërin e preventivit Germim dhe me eskavator.

2- motobetoniere 2 copë

Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni janë kërkuar 2 motobetoniere.

3- Kamioncinë 1 cope

Eshtë kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve.

4. Kamion vetshkarkues me mase maksimale të autorizuar sipas lejes së qarkullimit nga 16 ton deri 18 ton

Eshtë kërkuar 1 kamion vetshkarkues për transportin e materialeve të ndryshme

5-fadrome

Bazuar në zërat e preventivit për punime prishje mur soleta etj është kërkuar 1 fadrome

6-Kamion me vinc

Eshtë kërkuar 1 kamion me vinc për të ngritur tubot apo materialet e tjera sipas zerave të punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.